

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga C.R.E. Jazamut Ltd., me seli në adresën rr. Horesh HaAlonim nr. 12, Ramat Yishai, Izrael, nëpërmjet avokatit Aleksandar Krsteski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 22.04.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin C.R.E. Jazamut Ltd., me seli në adresën rr. Horesh HaAlonim nr. 12, Ramat Yishai, Izrael, do të fitojë kontroll mbi Shoqërinë për tregti dhe shërbime DABUR1 SHPKNJP import-eksport Shkup, me seli të regjistruar në rr. Franklin Ruzvelt nr. 1/6, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së pjesës, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 31.03.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga C.R.E. Jazamut Ltd., me seli në adresën rr. Horesh HaAlonim nr. 12, Ramat Yishai, Izrael, me të cilin C.R.E. Jazamut Ltd. do të fitojë kontroll të vetëm mbi DABUR1 SHPKNJP import-eksport Shkup, me seli të regjistruar në rr. Franklin Ruzvelt nr. 1/6, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së pjesës.

Komisioni filloi me ekzaminimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Veprimtaria kryesore e C.R.E. Jazamut Ltd. është zhvillimi dhe sipërmarrja e projekteve jashtë Izraelit, kryesisht në sektorin e energjisë, me aktivitete në SHBA, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi. C.R.E. Jazamut Ltd. aktualisht është pronar i 6 projekteve energjetike.

C.R.E. Jazamut Ltd. nuk ka persona juridikë të ndërlidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar të hyra në tregun maqedonas.

DABUR1 SHPKNJP import-eksport Shkup është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, veprimtaria prioritare e regjistruar e së cilës është magazinimi i energjisë elektrike.

DABUR1 SHPKNJP import-eksport Shkup nuk ka gjeneruar qarkullim për vitin 2025, përkatësisht nuk realizon asnjë lloj qarkullimi në tregun relevant në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ